



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

V E N D I M

PËR SHYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË ALEANCA KUQ E ZI PJESË E KOALICIONIT SHPRESA PËR NDRYSHIM (SHN), PËR DORËZIMIN E DOKUMENTAVE PËR REGJISTRIMIN E LISTËS SHUMEMËRORE TË KANDIDATËVE PËR ANËTARË NË KËSHILLIN E BASHKISË VLORE PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 19.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për shyrtrimin e kërkesës së Partisë Aleanca Kuq e Zi pjesë e Koalicionit "Shpresa për ndryshim (SH.N)", për dorëzimin e dokumentave për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për anëtarë në Këshillin e Bashkisë Vlorë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a", neni 67, pika 2, neni 165, pika 3 neni 72 dhe neni 73, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Partia Aleanca Kuq e Zi pjesë e Koalicionit "Shpresa për Ndryshim (SH.N)", si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N:

Aleanca Kuq e Zi pjesë e Koalicionit "Shpresa për Ndryshim (SH.N)", me vendimin e KQZ-së nr. 203, datë 23.04.2019, është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019.



Nr. 590 i Vendimit

Data 19.05.2019

Ora 18:00 e Vendimit

Për shyrtrimin e kërkesës së Koalicionit "Shpresa për Ndryshim (SH.N)", për dorëzimin e dokumentave për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për anëtarë në Këshillin e Bashkisë Vlorë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

Znj. Lumturi Ratkoceri ka depozituar në KQZ dokumentacionin me nr. 3712 prot., datë 16.05.2019 për regjistrimin e kandidatëve për anëtar Këshilli në Bashkinë Vlorë.

Në bazë të nenit 67, pika 1, Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë parashikon se "Partia politike që është regjistruar në KQZ si subjekt zgjedhor për zgjedhje, depoziton në KQZ listën shumëmemërore të kandidatëve të saj për çdo zonë zgjedhore jo më vonë se 50 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, kandidati për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore dhe lista e kandidatëve për këshillat vendorë regjistrohen në KZAZ-në që mbulon njësinë e qeverisjes vendore brenda afatit të përcaktuar në këtë pikë. KZAZ-ja dorëzon një kopje të listës në KQZ brenda 48 orëve.

Bazuar në nenin 67, pika 1 dhe të Kodit Zgjedhor, për zgjedhjet në organet e qeverisjes vendore, dokumentacioni i depozituar nga kryetari znj. Lumturi Ratkoceri, përfaqësues i Partisë Aleanca Kuq e Zi pjesë e Koalicionit "Shpresa për Ndryshim (SH.N)", është jashtë afatit të përcaktuar.

Në këto kushte, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve konstaton se dokumentacioni i paraqitur paraqitur nga znj. Lumturi Ratkoceri, përfaqësues i Partisë Aleanca Kuq e Zi pjesë e Koalicionit "Shpresa për Ndryshim (SH.N)", është në kundërshtim me pikën 1 të nenit 72 të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 23, pika 1, germa a, nenin 67, pikat 1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Mospranimin e kërkesës së Partisë Aleanca Kuq e Zi pjesë e Koalicionit "Shpresa për Ndryshim (SH.N)", për dorëzimin e dokumentave për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve për anëtarë në Këshillin e Bashkisë Vlorë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datë 30 qershor 2019.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr. 590 i Vendimit

Data 19.05.2019

Ora 18:00 e Vendimit

Për shyrtrimin e kërkesës së Koalicionit "Shpresa për Ndryshim (SH.N)", për dorëzimin e dokumentave për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve për anëtarë në Këshillin e Bashkisë Vlorë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019